



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:298099

Datë: 27.07.2020

Numri i dokumentit: 01040510

P.nr.1764/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës Vjollca Bushala, me sekretarën juridike Drita Germizaj, në lëndën penale, kundër të akuzuarit A.T nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2484-5/2019 të dt.26.12.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në praninë e Prokurorit të Shetit në Prizren, Milot Krasniqi, të akuzuari A.T, me datën 15.07.2020, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

A.T, nga i ati U. dhe e ëma M., e lindur Gashi, i lindur më ..., në ... të Republikës së Gjermanis, tani me banim në Prizren, Lagjen "...", rruga "...", shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal..., të lëshuar nga MPB Prishtinë.

Konform nenit 363 par.1 nën parag. 1.2 të KPP-së.

REFUZOHET AKUZA

Me dt.12.09.2019, rreth orës 12:20, i akuzuari duke e shfrytëzuar pozitën dhe autorizimet e tij- detyrat e punës "...", pran të dëmtuares ..., në Prishtinë, në piken shitëse "...", në Prizren, duke keqpërdorur autorizimet lidhur me përkujdesjen e pasurisë së të dëmtuarës, i akuzuari ditën kritike me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete apo personin, me dashje ka marrur 6 kg kafe të produktit "...", me çka të dëmtuarës i shkakton dëme të konsiderueshme materiale.

- Me këtë veprim ka kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 330 parag. 1 të KPRK-së.

-Për shkak se e Prokurorit të Shetit në Prizren – në shqyrtimin gjyqësor në mbështetje të nenit 363 par.1 nën parag. 1. 2 të KPP, është tërhequr nga akuza, sepse i akuzuari për të njëjten veprë është gjykuar me aktgjykim të formës së prer.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i

Prokuroria Themelore ne Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2484-5/2019 të dt.26.12.2019, kundër të kundër të akuzuarit akuzuarit A.T nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 të KP-së

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 15.07.2020 i akuzuari A.T, nuk e ka pranuar veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, pasi që për të njëjtën qështje është gjykuar tek gjyqtari Luan Berisha dhe gjykytës si provë materiale i ka prezentuar aktgjykimin me numër p.nr1450/19 të datës 09.12.2019 .

Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: pas shqimit të aktgjykimit të kësaj gjykate P.nr. 1450/12 të datës 09.12 2019, rrjedh se këtu i akuzuari A.T nga Prizreni sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr2310-2/19 të datës 30.10.2019 është shpallur fajtor për veprën penale të njëjt, andaj nga rrethana dhe ky shkak ligjor bazuar në nenin 4 të KPPK-së, tërhiqem nga ndjekja penale e mëtejme pasi që kjo qështje konsiderohet qështje e gjykuar.

Meqenëse Prokurori i Shtetit i Prokuroris Themelore në Prizren, gjatë shqyrtimit fillestar është tërhequr nga akuza kundër të akuzuarit A.T, gjykata konform nenit 363 par.1 nën parag. 1 .2 të KPP ka vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të nenit 363 par.1 nën parag. 1. 2 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2019:298099, 27.07.2020

G j y q t a r i

Vjollca Buzhala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.